



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Ligji Nr. 08/L-213**

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 08/L-193 MBI  
NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
PËR VITIN 2023**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës,**

Në mbështetje të nenit 65, paragrafëve (1) dhe (5) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 08/L-193 MBI  
NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
PËR VITIN 2023**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim të ndryshojë dhe plotësojë Ligjin Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023.

## **Neni 2** **Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë Ligj kanë kuptimet si në vijim:

1.1. **Ligji bazik** – nënkupton Ligjin Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023.

2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë Ligj kanë kuptimin e përcaktuar sipas Ligjit bazik.

## **Neni 3**

Neni 4 i Ligjit bazik, pas paragrafit 3 shtohet paragraf i ri me numrin rendor 4, me tekstin si në vijim:

4. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, me rastin e pranimin të fondeve nga Banka Botërore në shumë prej pesëmbëdhjetë (15) milionë euro, autorizohet Qeveria që me vendim të rrisë kufirin e shpenzimit dhe të buxhetojë vlerën prej pesëmbëdhjetë (15) milionë euro në programin Shpenzimet e Paparashikuara me kod 232, në nën-programin Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, në kategorinë e shpenzimeve “Rezerva”, burimi i financimit Huamarrja (04). Autorizohet Ministri që të reflektojë ndryshimet në tabelat buxhetore 1, 1.1., 2 dhe 3.1, me rastin e pranimin të fondeve dhe pas buxhetimit të tyre me Vendimin e Qeverisë. Për ndarjen buxhetore sipas këtij paragrafi, lejohet tejkalimi i përkohshëm në planifikim i deficitit sipas rregullës fiskale, me kusht që përgjatë ekzekutimit të Buxhetit të Republikës së Kosovës respektohet kufiri i deficitit sipas rregullës fiskale.

## **Neni 4**

Në nenin 15 të Ligjit bazik, paragrafi 9 riformulohet si në vijim:

9. Aprovimi paraprak nga Kuvendi kërkohet për çdo transfer ndërmjet OB-ve, me përjashtim të paragrafëve 2, 3 dhe 5 të këtij neni, si dhe transferit të mjeteve nga një OB në tjetrën me vendim të Ministrit, në rastet kur një OB ka mjete tepriçë në kuadër të mjeteve të ndara buxhetore në kategorinë e shpenzimeve ‘Paga dhe Shtesa’, për zbatim efikas të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik.

## **Neni 5**

Pas nenit 15 të Ligjit bazik, shtohet neni i ri **15A** me tekstin si në vijim:

## **Neni 15A**

Autorizohet Ministri që sipas nevojës me vendim të bëjë ngritjen e tavanit të shtesave dhe kompensimeve të përcaktuara me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, për vitin fiskal 2023.

## **Neni 6**

Në nenin 17 të Ligjit bazik, pas paragrafit 7 shtohet paragrafi i ri 8 si në vijim:

8. Vlera monetare e koeficientit për Ligjin për Pagat në Sektorin Publik është njëqind e pesë (105 €) euro.

## **Neni 7 Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 08/L-213  
9 shkurt 2023**

**Glauk KONJUFCA**

---

**Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës**